



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
Fakulteti Ekonomik

MAKROEKONOMIA 1

Syllabusi

Prof.dr. Avdullah Hoti

1

Në këtë ligjëratë do të njiheni me:

1. Syllabusin

2

INFORMATAT THEMELORE PËR LËNDËN

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Makroekonomia 1
Niveli:	BA
Statusi lëndës:	E obligueshme
Viti i studimeve:	Viti i I, Semestri II
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	8
Koha / lokacioni:	<i>Caktohet nga dekanati në fillim të vitit</i>
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.dr. Avdulkah Hoti
Detajet kontaktuese:	Fakulteti Ekonomik, UP, Kati 6, kabineti 75 Email: Avdullah.Hoti@uni-pr.edu Konsultimet: <i>caktohen në fillim të semestrit</i>

3

PËRSHKRIMI I LËNDËS

- Temat të trajtohen:
 - Principet kryesore makroekonomike,
 - Matjen e aktivitetit ekonomik kombëtar,
 - Kërkesa agregate dhe oferta agregate,
 - Konsumi dhe investimet,
 - Rritja ekonomike dhe ciklet e biznesit,
 - Papunësia,
 - Politikat fiskale dhe monetare dhe tema të tjera.
- Trajtimi i këtyre temave mundëson që të diskutohen çështjet që kanë të bëjnë me: inflacionin, papunësinë, rritjen ekonomike, sistemin bankar dhe lidhjet ekonomike ndërkombëtare.
- Në këtë kurs trajtohen edhe politikat dhe instrumentet e ndërhyrjes së shtetit në ekonomi

4

QËLLIMET E LËNDËS

Ky kurs ka për qëllim t'i pajisë studentët për:

1. Funksionimin e ekonomisë kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe politikat ekonomike të zbatueshme, si dhe
2. Konceptet bashkëkohore makroekonomike, të cilat mund të përdoren për të diskutuar dhe vlerësuar në mënyrë kritike politikat dhe zhvillimet aktuale makroekonomike.

5

REZULTATET E PRITURA TË NXËNIES

Me mbarimin e këtij kursi, studentët pritet:

1. Të formojnë opinionin e tyre në lidhje me situatën ekonomike në vend dhe problemet e rritjes ekonomike duke përdorur treguesit makroekonomik të shpjeguar gjatë këtij kursi,
2. Të vlerësojnë efektin e politikave fiskale dhe monetare në agregatët kryesorë makroekonomik në kontekst të situatave të caktuara,
3. Të vlerësojnë efektet e lidhjeve ndërkombëtare në ekonominë e vendit,
4. Të prezantojnë, në forme grafike dhe përmes modeleve të thjeshta matematikore, opinionet e tyre mbi problemet/situatat ekonomike.

6

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

- Çdo javë nga 3 orë ligjërata dhe 2 orë ushtrime.
- Pas çdo ligjërata jepen detyra për ese,
- Studentët inkurajohen që të përcjellin rrjedhat ekonomike në vend dhe jashtë, revistat dhe internetin dhe të nxjerrin tema për diskutim.
- Mësimdhënia do të përqendrohet në pjesëmarrjen aktive të studentëve në procesin e mëimit, me prezantime individuale e grupore, me komente mbi ligjëratën/prezantimin e mësimdhënësit etj.


7

LITERATURA

Literatura	
Literatura bazë:	Paul A. Samuelson and William D. Nordhaus (2010): Economics, Published by McGrawHill/Irvin, 19th edition, (translated to Albanian by Avdullah Hoti, published in Albanian by Kosovo Education Centre in 2022).
Literatura shtesë:	Raportet e Bankës Qëndrore të Kosovës, Entit të Statistikave të Kosovës, Ministrisë së Financave, Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar etj. që kanë të bëjnë me temat që ligjërohen në këtë kurs (për secilën temë studentët do të udhëzohen se cilin raport të këtyre institucioneve duhet ta lexojnë).

8

LITERATURA



EKONOMIKSI

Botimi i nëntëmbëdhjetë

PAUL A. SAMUELSON

Profesor Emeritus i Institutit
për Teknologji i Massachusetts

WILLIAM D. NORDHAUS

Profesor Sterling i Ekonomiksit
Universiteti Yale

Përkthyer dhe përkthues nga:
Ardeshah Hot, Profesor i Shqipëri, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Ekonomik, Prishtinë

McGraw-Hill
Irwin

Boston/Burr Ridge, IL, Dubuque, IA, New York, San Francisco, St. Louis, Bangalore,
Bogotá, Caracas, Kuala Lumpur, Lisbon, London, Madrid, Mexico City, Milan,
Mumbai, New Delhi, Santiago, Seoul, Singapore, Sydney, Taipei, Toronto

9

LITERATURA

PJESA E PESTË	MAKROEKONOMIKSI: RRRITJA EKONOMIKE DHE ÇIKLET E BIZNESIT	365
Kapitulli 19	Përmbledhje e Makroekonomiksit	367
Shtojca 19	Të dhënat makroekonomike për Shtetet e Bashkuara	385
Kapitulli 20	Matja e aktivitetit ekonomik	386
Kapitulli 21	Konsumi dhe investimi	408
Kapitulli 22	Çiklet e biznesit dhe kërkesa agregate	428
Kapitulli 23	Paraja dhe sistemi financiar	453
Kapitulli 24	Politika monetare dhe ekonomia	475
PJESA E GJASHTË	RRITJA, ZHVILLIMI DHE EKONOMIA GLOBALE	499
Kapitulli 25	Rritja ekonomike	501
Kapitulli 26	Sfida e zhvillimit ekonomik	521
Kapitulli 27	Kurset e këmbimit dhe sistemi financiar ndërkombëtar	543
Kapitulli 28	Makroekonomiksi i ekonomisë së hapur	564
PJESA E SHTATË	PAPUNËSIA, INFLACIONI DHE POLITIKA EKONOMIKE	587
Kapitulli 29	Papunësia dhe bazat e ofertës agregate	589
Kapitulli 30	Inflacioni	609
Kapitulli 31	Kufijtë e makroekonomiksit	630

10

VLERËSIMI I STUDENTËVE 1

Nota finale përbëhet nga:

- Vlerësimi i parë: 20%
- Vlerësimi i dytë 20%
- Seminaret 10%
- Provimi final 50 %
- Total 100%

11

VLERËSIMI I STUDENTËVE 2

Gjatë vlerësimit merren parasysh edhe këto aspekte:

- interpretimi i temës,
- thellësia e të kuptuarit të temës,
- shfrytëzimi i literaturës,
- evaluimi dhe sinteza e evidencës,
- analizat kritike dhe
- logjika e ndërtimit të argumentit.

Përveç kësaj, vëmendje në vlerësim u kushtohet edhe:

- drejtshkrimin,
- prezantimin vizual të të dhënave dhe referencave,
- gjatësisë së shkrimit dhe
- prezantimit të përgjithshëm.

12

PLANI I LIGJËRATAVE

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Parimet themelore të makroekonomisë dhe ekonomitë moderne
Java e dytë:	Matja e aktivitetit ekonomik
Java e tretë:	Konsumi dhe investimi
Java e katërt:	Ciklet e biznesit dhe kërkesa agregate
Java e pestë:	Paraja dhe sistemi financiar
Java e gjashtë:	Politika monetare dhe ekonomia
Java e shtatë:	Vlerësimi i parë
Java e tetë:	Rritja ekonomike
Java e nëntë:	Sfida e zhvillimit ekonomik
Java e dhjetë:	Kurset e këmbimit dhe sistemi financiar ndërkombëtar
Java e njëmbëdhjetë:	Makroekonomiksi i ekonomisë së hapur
Java e dymbëdhjetë:	Papunësia dhe bazat e ofertës agregate
Java e trembëdhjetë:	Inflacioni
Java e katërbëdhjetë:	Kufijtë e makroekonomiksit
Java e pesëmbëdhjetë:	Vlerësimi i dytë

13

UDHËZIME PËR SEMINAR

- Seminari duhet të jetë rreth 10 faqe .
- Struktura e seminarit:
 1. Hyrja (qellimi i seminarit, permbajtja, te dhenat etj)
 2. Teoria (qeshtje teorike te temes qe keni zgjedhur, definime te variablave)
 3. Te dhenat empirike (pershkrimi i te dhenave per ilustrimin e temes tuaj, disa statistika deskriptive)
 4. Rezultatet (perdorimi i te dhenave per te spjeguar temen qe keni zgjedhur)
 5. Konkluzionet (rezultatet kryesore te hulumtimit)
 6. Literatura
 7. Aneks me te dhena (nese keni tabela shtese)
- Seminari duhet te prezantohet ne javën kur diskutohet ajo teme.
 - Pas ketij prezentimi, implementohen komentet dhe dorezohet seminari

PËRFUNDIM

Ndonjë pyetje?